Fixrock 33 VF

Fasadat e ventiluara

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Panele izoluese prej leshi guri me densitet mesatar. Panelet janë të veshura në njërën anë me një vello xhami të zezë dhe janë të papërshkueshme nga uji në të gjithë seksionin.

APLIKIMI

Panelet ROCKWOOL Fixrock 33 VF përdoren si izolues termik, akustik dhe zjarrit të fasadave të ventiluara. Shtresa e izolimit termik nën mbulesën përfundimtare shpesh është e ekspozuar ndaj ndikimeve atmosferike, kështu që duhet të jetë e papërshkueshme nga uji. Velloja e xhamit mbron sipërfaqen e panelit të leshit të gurit nga gërryerja që mund të shkaktohet nga rrymat e forta të ajrit. Përveç kësaj, velloja shërben për të përmirësuar pamjen estetike të fasadës me fuga të hapura. Mbërthimi mekanik i paneleve kryhet me fiksim (minimumi dy fiksues për panel)

VETITË

- material rezistent ndaj zjarrit - reagimi ndaj zjarrit klasa A1
- vetitë izoluese akustike - me strukturën e tij të fijëzuar, kontribuon në fuqinë izoluese akustike të konstruksionit.
- veti të shkëlqyera për izolim termik - koeficient i ulët i përçueshmërisë termike (λ).
- qëndrueshmëri - velloja e xhamit mbron sipërfaqen e panelit të leshit të gurit nga gërryerja e shkaktuar nga rrymat e forta të ajrit.
- përshkueshmëria e avullit.
- rezistenca ndaj ujit.
- qëndrueshmëri dimensionale.
- neutraliteti kimit.

PËRMASAT E PRODUKTIT DHE PAKETIMI

Trashësia (mm)	50	60	80	100	120	140	150	160	180
Gjatësia & Gjerësia (mm)	1200 x 600								
m² / paketim	2,88	2,88	2,16	1,44	1,44	2,16	1,44	1,44	1,44
m² / palet	74,88	63,36	47,52	37,44	31,67	25,92	23,04	23,04	20,16

Dimensionet e paletës 1200 x 1200 x maksimumi 2760 mm.

PARAMETRAT TEKNIK

Vetitë	Simboli	Vlera	Standarti
Reagimi ndaj zjarrit	-	A1	EN 13501-1
Rezistenca ndaj fluksit të ajrit	AF_r 25	≥ 25 kPa·s/m²	EN ISO 9053
Përçueshmëria termike e deklaruar	λ_D	0,033 W/[mK]	EN 12667
Toleranca e trashësisë	T4	- 3 mm / + 5 mm	EN ISO 29466
Absorbimi afatshkurtër i ujit	WS	≤ 1kg/m²	EN ISO 29767
Absorbimi afatgjatë i ujit	WL(P)	≤ 3 kg/m²	EN 12087
Dendësia	ρ	70 kg/m³	EN 1602
Përshkueshmëria ndaj avullit	MU 1	μ = 1	EN 12086
Pika e shkrirjes	T_t	> 1000°C	DIN 4102
	trashësia		
Çelësi i markimit	40-180 mm	MW-EN 13162-T4-DS(70,90)-WS-WL(P)-MU1-AFr12***	
Deklarata e Performancës (DoP)	40-180 mm	CPR-DoP-ADR-118	

*MW - lesh mineral; EN - standard evropian; Ti - toleranca e trashësisë e; DS(70,90) – qëndrueshmëri dimensionale në kushte të caktuara të temperaturës dhe lagështisë relative të ajrit; WS – absorbimi afatshkurtër i ujitt; WL(P) - absorbimi afatgjatë i ujit; MUi – difuzioni i avullit të ujit (përshkueshmëria e avullit); AF_r - rezistenca e fluksit të ajrit.

TRASHËSIA dhe R_D

Trashësia (mm)	50	60	80	100	120	140	150	160	180
Rezistenca Termike R_D [m²K/W]	1,50	1,80	2,40	3,00	3,60	4,20	4,50	4,80	5,45

ROCKWOOL ADRIATIC d.o.o.
Selia dhe prodhimi, Poduzetnička zona Pićan Jug 130, Zajci
HR – 52333 Potpićan
Zyra e Shitjes, Radnička cesta 80, HR - 10000 Zagreb
Tel +385 1 6197 600
www.rockwool.al

Të gjitha informacionet që përmbahen në këtë dokument kanë të bëjnë me vetitë e produktit të aplikueshme në momentin e lëshimit. Ju lutemi, gjithmonë pyesni distributorin tuaj për Skedën Teknike më të fundit, duke qenë se ne punojmë në vazhdimësi për zhvillimin e produkteve.